



E premte 24 gusht 2018

SQARIM PËR PUBLIKUN

NDIKIMI I PARAMETRAVE RREGULLATIV NË TARIFAT E ENERGISË ELEKTRIKE

Pas miratimit të Parametrave për Periudhën e dytë Rregullative 2018 – 2022, përmes mediave elektronike dhe të shkruara, disa organizata të shoqërisë civile dhe individ të tjerë kanë bërë reagime, vlerësime dhe kualifikime nga më të ndryshmet, të cilat janë në kundërshtim me realitetin për sa i përket reflektimit të këtyre Parametrave në rritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Për ZRRE-në disa nga këto vlerësime dhe reagime janë jo profesionale dhe mundë të krijojnë opinion joreal tek konsumatorët. Prandaj si të tilla për ZRRE-në janë të papranueshme, cenojnë integritetin dhe profesionalizmin e ZRRE-së dhe për më tepër dezinformojnë opinionin.

ZRRE, në pajtim të plotë me ligjet e energjisë, me profesionalizëm dhe në mënyrë transparente ka vlerësuar dhe ka vendosur Pramatrat e ri Rregullativ të cilët nuk do të kenë ndikim në rritjen e tarifave të energjisë elektrike për vitin 2018, siç është proklamuar ditëve të fundit në media. Vendosja e këtyre parametrave do të sigurojë stabilitet të operimit dhe funksionimit të sistemit në dobi të konsumatorëve.

Bazuar në këta Parametra Rregullativ, prej sot ZRRE ka lëshuar në konsultim publik raportet me të hyrat maksimale të Lejuara për KOSTT dhe KEDS të propozuara për periudhën 2018 - 2022. Konsultimet publike do të zgjasin dy javë dhe të licencuarit, shoqëia civile, konsumatorët dhe të gjitha palët e tjera të interesit do të kenë mundësi të paraqesin vërejtjet dhe komentet e tyre.

ZRRE-ja siguron qytetarët e vendit se mbetet e përkushtuar që në pajtim të plotë me ligjin, në mënyrë profesionale dhe transparente do të punojë për zhvillimin e sektorit energjetik duke pasur për qëllim që të sigurohen shërbime sa më cilësore të furnizimit me energji elektrike dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për vendin.